

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit Programi Fillor
Titulli i lëndës:	Letërsi për fëmijë
Niveli:	Bacherer
Statusi lëndës:	O
Viti i studimeve:	II, sem. IV
Numri i orëve në javë:	5 , 3+2
Vlera në kredi – ECTS:	5 ECTS
Koha / lokacioni:	Fakulteti i Edukimit
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.asc.dr. Myrvete Dreshaj-Baliu
Detajet kontaktuese:	044/257972, myrvete_dreshaj_baliu@yahoo.com
Përshkrimi i lëndës	
	Lënda përkufizon krijimtarinë letrare-artistike që krijohet për moshat e vogla (nxënësit fillorë), krijimtari e cila është e mëvetësishme nga ajo për të rritur. Kjo lëndë argumenton rëndësinë e madhe që ka prodhimi letrar artistik për fëmijë në fazat e zhvillimit të moshave të njoma, të edukimit të tyre dhe të formimit të karakterit e të shijes estetike. Kjo letërsi duke bërë ndikim estetik në marrësin (lexuesin fëmijë e të rritur) mundëson pasurimin shpirtëror të tij, njohjen e botës dhe vetvetes.
Qëllimet e lëndës:	Studentët të njihen me premiset, nocionet dhe konceptet e letërsisë për fëmijë dhe me arsyet e ndarjes së mëvetësishme nga pjesa tjetër e letërsisë së përgjithshme. Identifikojnë funksionet transmetuese që realizon kjo letërsi dhe rëndësinë e tyre që kanë në formimin e karakterit e të shijes estetike të grupmoshave të caktuara. Përshkruajnë dhe vlerësojnë këtë proces të veçantë letrar-artistik dhe përforcojnë njohurit për proceset letrare artistike përgjithësisht, për tipologjinë, për stilet letrare, strukturat poetike, gjinitë, llojet e zhanret dhe njihen me një sërë kërkesash të tjera letrare, pedagogjike, psikike e edukative që duhet t'i realizojë kjo krijimtari letrare për fëmijë. Më këtë lëndë studentët, po ashtu, thellojnë njohurit bazë për trashëgiminë historike, kulturore, letrare dhe edukative të letërsisë shqipe për fëmijë dhe zbërthejnë vlerat e saj duke trajtuar autorët më përfaqësues të kësaj letërsie, që më vonë t'i procedojnë këto njohuri si pedagogë dhe si qytetarë akademikë.
Rezultatet e pritura të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> • Fitimi i njohurive dhe i shkathtësive bazë, duke shfrytëzuar njohuritë elementare të marra më parë për këtë proces të caktuar letrar, i cili për zhvillimin e tij duhet të plotësojë edhe një sërë kërkesash të tjera letrare, edukative, pedagogjike e psikike. Kjo lëndë përforcon kulturën e leximit,

	shkrimit, komunikimit, fisnikërimit të shpirtit dhe, së fundi, u jep studentëve mundësinë e përjetimit dhe të interpretimit me kompetencë profesionale të teksteve letrare nga kjo fushë.
--	---

Aktiviteti	Orë	Ditë	Javë	Gjithsej
Ligjërata	3	16	16	64 orë
Ushtrime teorike/laboratorike	2	16	16	32 orë
Punë praktike	/	/	/	/
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	1	16	16
Ushtrime në terren	/	/	/	/
Kollokfiume,seminare	1	1	16	16
Detyra të shtëpisë	5	5	5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	16	16	48 orë
Përgaditja përfundimtare për provim	3	3	/	9 orë
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	4	/	8 orë
Projektet, prezantimet ,etj	1	10	10	10
Totali				212 orë

Plani i dizajnuar i mëimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Koncepti dhe objekti i letërsisë për fëmijë
Java e dytë:	Vlerësime të pedagogëve të njohur, të studiuesve dhe shkrimtarëve për këtë fushë
Java e tretë:	Ndarja në grupmosha e letërsisë për fëmijë
Java e katërt:	Periodizimi i letërsisë shqipe për fëmijë dhe autorët përfaqësues
Java e pestë:	Funksionet e letërsisë për fëmijë
Java e gjashtë:	Burimet e letërsisë shqipe për fëmijë
Java e shtatë:	Veçanti të stilit në letërsinë për fëmijë
Java e tetë:	Figurat stilistike – specifika të përdorimit dhe testi i parë vlerësues
Java e nëntë:	Tema dhe veçantia e saj në veprat letrare për fëmijë
Java e dhjetë:	Gjinitë, llojet dhe zhanret letrare për fëmijë
Java e njëmbëdhjetë:	Roli i ilustrimit në krijimtarinë për fëmijë
Java e dymbëdhjetë:	Autorë të krijimeve për fëmijë gjatë Rilindjes
Java e trembëdhjetë:	Autorë dhe veçanti të krijimeve gjatë gjysmës së parë të shek. XX
Java e katërbëdhjetë:	Krijimtaria e sotme letrare për fëmijë
Java e pesëmbëdhjetë:	Krijimtaria e sotme letrare për fëmijë – autorë dhe vepra

Metodologjia e mësimdhënies:	<i>Leksione, diskutime, punë e pavarur individuale, punë në grupe, seminare dhe prezantime)</i>
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi mbështetet në këto aktivitete: Pjesëmarrja dhe diskutimi në klasë 10% Provimi gjysmësemestral 40 % Provimi përfundimtar 50 % Totali 100 % Nota përfundimtare : Pikët (%) Nota 91-100 10 81-90 9 71-80 8

	61-70 7 51-60 6
Literatura	
Literatura bazë:	Dr. sc. Faik Shkodra, Letërsia për fëmijë nga fillimet deri sot , Prishtinë, 2002. Prof. as. dr. Astrit Bishqemi, Hyrje në teorinë e letërsisë për fëmijë , “Sejko”, Elbasan, 2004.
Literatura shtesë:	Bedri Dedja (dhe të tjerë studiues), Letërsia për fëmijë , Tiranë, 1973. - Bardhosh Gaçe, Letërsia shqipe për fëmijë , Vlorë, 2006. - Agim Deva, Romani ynë për fëmijë , Prishtinë, 1977. - Agim Deva, Poezia shqipe për fëmijë (1872-1980) , Prishtinë, 1982. - Bedri Dedja, Burimet e letërsisë shqipe për fëmijë , Prishtinë, 1978.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<ul style="list-style-type: none"> - Studentët janë të lirë të bëjnë pyetje dhe të marrin pjesë në çdo aktivitet - Gjatë orëve mësimore dhe provimeve nuk lejohen telefonat celularë - Nuk lejohet ardhja me vonesë apo largimi nga ora pa arsye - Nuk lejohet KOPJIMI dhe cilado formë tjetër e mashtrimit gjatë provimeve - Studenti i vërtetohet vijimi i rregullt (vijueshmëria është së paku 80% nga numri i përgjithshëm i orëve të planifikuara) 	